



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegjit "Dardania":
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS;
 - Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS
 - Arkitekturë dhe Planifikim Urban, BA, 180 ECTS
 - Psikologji Organizative, MA, 120 ECTS
2. Hiqet masa e pezullimit për programin e studimit të BPrAL Kolegjit "Dardania":
 - Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS
3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, BPrAL Kolegjit "Dardania" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar në të dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS, Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS, Arkitekturë dhe Planifikim Urban, BA, 180 ECTS, dhe Psikologji Organizative, MA, 120 ECTS (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018)

konfirmohet se për këto programe të studimit nuk ka staf akademik të mjaftuar të fushës së studimit si bartës të programeve të cekura me lartë.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: “Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve”. Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie te rregullt te punës me gradën shkencore PhD (Dr.sc.) dhe te jetë i fushës së programit të studimit.

1. Për programin e studimit: Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS, BPrAL Kolegjit “Dardania” si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Naser Shabani, Bilall Kasami, Edlir Orhani, dhe Nexhat Avdiu. Pas kontrollimit te dokumentacionit te kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që Naser Shabani dhe Bilall Kasami i përkasin fushës së ekonomisë, ndërsa Edlir Orhani është i fushës se arkeologjisë, dhe Nexhat Avdiu i fushës se gjeografisë. Sipas nenit 26, pika 5.3.4 për programin tre vjeçar (180 ECTS) duhet te jenë te paktën 3 staf akademik si bartës të programit ne marrëdhënie te rregullt te punës me gradën shkencore Dr.sc., dhe te jenë të fushës së studimit. Nga çka u tha me sipër, konstatohet se vetëm 2 persona i përkasin fushës se ekonomisë, ndërsa dy te tjerë nuk kanë lidhje me ketë fushë të programit të studimit. Andaj mbi ketë bazë në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
2. Për programin e studimit: Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS, Kolegjit “Dardania” si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Jusuf Mustafai, Majlinda Bregasi , Jetmire Zeqiri. Sipas nenit 26, pika 5.3.4 për programin tre vjeçar (180 ECTS) duhet te jenë te paktën 3 staf akademik si bartës të programit ne marrëdhënie te rregullt te punës me gradën shkencore Dr.sc., dhe te jenë të fushës së studimit. Nga çka u tha me sipër, konstatohet se Kolegji “Dardania” për ketë program te studimit nuk ka staf të mjaftueshëm sipas nenit 26, pika 5.3.4, pasi që Jetmir Zeqiri është Dr.sc i shkencave juridike, Majlinda Bregasi është filologe në programin gjuhë dhe letërsi shqipe, ndërsa Jusuf Mustafaj sipas të dhënave të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës, konsiston te ketë edhe një marrëdhënie të rregullt të punës, çka bie ne kundërshtim me nenin 26, pika 5.3.4, 5.3.14, dhe 5.3.15. Nga shpjegimet e dhëna me sipër për bartësit e këtij programi të studimit, konstatohet që ky program i studimit nuk ka staf akademik sipas nenit 26, pika 5.3.4, dhe mbi ketë bazë KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. Për programin e studimit: Arkitekturë dhe Planifikim Urban, BA, 180 ECTS, sipas të dhënave të prezantuara nga Kolegjit “Dardania”, konfirmohet se për këtë program të studimit ky institucion nuk ka asnjë staf akademik si bartës të programeve të cekura me lartë. Bazuar në mungesën e stafit akademik, KSHC vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.
4. Për programin e studimit: Psikologji Organizative, MA, 120 ECTS, sipas të dhënave të prezantuara nga Kolegjit “Dardania”, konfirmohet se për këtë program të studimit ky institucion nuk ka asnjë staf akademik si bartës të programeve të cekura me lartë. Bazuar në mungesën e stafit akademik, KSHC vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.
5. Për programin e studimit: Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS, Kolegjit “Dardania”, si bartës të këtij programi ka vendosur: Njomza Krasniqi, Artan Kolnikaj, Muazam Halili. Pas vlerësimit të dosjes së stafit, u konstatua që bartësit e këtij te programi i përkasin fushës së studimit, dhe që kanë

dokumentacion te rregullt, dhe me këtë raste KSHC vendosi të aprovoj kërkesën e Kolegjit "Dardania" për heqjen e masës së pezullimit. Me këtë rast, KSHC vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.


6. Për programin e studimit: Administrim Biznesi dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, Kolegjit "Dardania", si bartës të këtij programi ka vendosur: Rilind Ademi, dhe Bekim Stafai. Pas vlerësimit të dosjes së stafit, u konstatua që bartësit e këtij te programi i përkasin fushës së studimit, dhe që kanë dokumentacion te rregullt, dhe me këtë raste KSHC vendosi të aprovoj kërkesën e Kolegjit "Dardania" për heqjen e masës së pezullimit. Me këtë rast, KSHC vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Në nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik të fushës së studimit për programet e studimit: Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS, dhe Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS, dhe në mungesë totale të stafit për programit të studimit: Arkitekturë dhe Planifikim Urban, BA, 180 ECTS, dhe Psikologji Organizative, MA, 120 ECTS, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegjit "Dardania";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

